VENDIM
Nr. 167, datë 24.3.2023

PËR KALIMIN TE BASHKIA DURRËS TË OBJEKTIT ARSIMOR, SHKOLLA 9-VJEÇARE DHE KOPSHTI "QEMAL MICI", BASHKIA DURRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 21, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin te Bashkia Durrës të objektit arsimor, shkolla 9-vjeçare dhe kopshti "Qemal Mici", Bashkia Durrës, sipas listës së inventarit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Bashkia Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

TË DHËNAT E PËRMBLEDHURA PËR OBJEKTET ARSIMORE (TABELA NR. 1)

Nr.	Qarku	Bashkia	Njësia Administrative	Niveli	Emërtimi	Tipologjia e ndërhyrjes	Financimi i Ndërtimit	Sipërfaqe (m^2)	Vlera e projektidesë	Vlera e projektit të zbatimit dhe të ndërtimit	Vlera e mbikëqyrësit	Vlera e kolaudimit	Vlera totale e objektit
4	Bashkia Durrës	Durrës	Durrës	9-vjeçare + kopsht	"Qemal Mici"	Ndërtim	Buxhet GoA	6,135.0	2,834,531.00	281,400,000.00	2,131,950.00	243,855.48	286,610,336.48
TOTAL								**6,135.0**	**2,834,531.0**	**281,400,000.0**	**2,131,950.0**	**243,855.5**	**286,610,336.5**